



BASHKIA E TIRANES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE
TERRITORIT
DREJTORIA E PROJEKTIMIT

RELACION TEKNIKE

EMËRTIMI I OBJEKTIT : NDËRTIMI I MIKROHAPËSIRAVE PUBLIKE NË TIRANË

Rreth projektit

Projekti i mikrohapësirave publike në Tiranë ka si qëllim kryesor krijimin e hapësirave publike dhe rikonceptimin e atyre ekzistuese pavarësisht shkallës së tyre, të mëdha apo të vogla, ato kanë forcën të forcojnë polet e krijuara, të krijojnë apo forcojnë identitetin e këtyre polëve, të shërbejnë si rekreacion për jetën e përditshme dhe të jenë një atraksion për Tiranën turistike.

Metodologjia

Bashkia e Tiranës me nderhyrjet në hapësirat publike (Sheshi Skenderbej, Pazari i Ri, Liqeni, Bulevardi i ri, Lojrat për fëmijë etj) ka treguar përthithjen e menjehershme nga banorët e qytetit të këtyre hapësirave, duke treguar në të njëjtën kohë mungesën e tyre për një kohë të gjatë në strukturën e qytetit. Kjo ka ndikuar në përjetimin me intensiv të qytetit, ka rritur vlerën e pronave rreth tyre, si dhe ka rritur në mënyrë të ndjeshme ofertën për turistët. Si një nevojë imediate këto investime janë përqendruar kryesisht në zonën qendrore të qytetit. Projekti i mikrohapësirave publike vjen si vazhdimi i konceptit për një qytet më të mirë me fokus këmbesor.

Tipologjitë e nderhyrjeve

Jane tre tipologji nderhyrjeje në mikrohapësirat publike. Hapësirat publike të ndermjetme, ritrajtim i hapësirave ekzistuese dhe hapësirat publike mes pallateve. Hapësirat publike të ndermjetme transformojnë hapësirat e mbipërdorura dhe të panevojshme për qarkullimin e makinave në hapësira publike. Këto hapësira publike rikonfigurojnë kryqezime që janë të pasigurta apo të përdorura, duke i kthyer në landmark të qytetit dhe duke impaktuar lagjen e biznesit përreth.

Ritrajtim i hapësirave publike ekzistuese ripërterijne funksionin dhe ndjesinë duke shfaqur potencialin e tyre të plotë në qytet

Hapesirat publike mes pallateve qe impaktojne komunitete

Strategji dizajni

Nderhyrjet ne keto hapësira jane te dizenuara te tilla qe te jene te indentifikueshme nga njera tjetra, te nxisin funksione te reja perdorimi dhe te jene hapësira publike me identitet te forte. Secila nga hapësirat ka element specifik te dizenuar enkas per ate hapësire. Format e perdoruara jane forma primitive, kjo e ben hapësiren publike funksionale por ne te njejten kohe edhe artistike, sherbejne si funksione baze per tu ulur apo hijezim por edhe nenfunksione si auditor, hije, reflektim, landmark, loje urbane etj, duke pasur si objektiv krijimin e nje rrjeti hapësirash publike ndjesore te dallueshme nga njera tjetra.

01 Objekti : Ndertimi i Mikrohapesirave Publike : Sheshi Kafe Flora

Mikrohapesira "Kafe Flora" kufizohet ne Veri-Lindje me rrugën " Mine Peza" dhe në Jug me rrugën e "Durrësit.

Përshkrimi i gjëndjes ekzistuese:

Sheshi përpara "Kafe Flora" duke qene se kufizohet nga dy rruget , aktualisht është një shëmbull tipik i mbipërdorimit te asfaltit dhe i kaosit ne lëvizjen e makinave, këmbësorëve dhe bicikletave.

Kjo bën që si kryqëzim te funksionojë keq duke pasur probleme me sigurinë rrugore . Rikonceptimi ka të bëjë me përcaktimin e qartë te mobilitetit persa i perket automjeteve, ashtu edhe të këmbësorëve dhe bicikletave. Duke arritur qartësin e mobilitetit hapësira që ngelet pervecse sherben si nje pasazh kalimi ajo kthehet ne identitetin e zones duke krijuar një zone urbane qe ofron vende per tu ulur, gjelbërim si dhe një atraksion urban.

Përdorimi:

Hapesira e re mendohet te jete jo vetem nje pike referimi (landmark) por edhe nje hapësire me funksione publike si: pushimi/ pritje alternative per kalimtarët ,parkim bicikletash qe presin ne hapësire urbane, me ndricim she sistemim i gjelberimit.

Qëllimi:

Projekti i mikrohapesires ne fjale ka si qellim kryesor krijimin e hapësires publike dhe rikonceptimin e asaj ekzistuese pavaresisht shkalles se vogel. Dizajni i "Kafe Flores" kaforce te theksoj polet e krijuara, te krijojne apo forcojne identitet e ketyre poleve, te sherbejne si rekreacion per jeten e perditshme dhe te jene nje atraksion per Tiranen turistike.

Elementët bazë:

1. Përcaktimi i qartë i mobilitetit, i lëvizjes së automjeteve dhe bicikletave
2. Hapësira e pasazhit, lëvizja e këmbësorëve – Pasazhi eshte nje konstruksion metalik si me mbulesë reflektues
3. Stacioni i bicikletave
4. Shtrimi me pllake guri
5. Gjelbërimi
6. Stola me veshje guri, modulare te unifikuara me shtrimin e mikrohapesires dhe me konfiguracion katrori te madhesive te ndryshme

Përshkrimi i projektit:

Mikrohapësira urbane "Kafe Flora". kufizohet nga dy anet me rruge si dhe godina e lokalit me te njejtin emer , i cili e identifikon këtë shesh.

Ka nje sipërfaqe 433m² dhe ndodhet ne prone publike . Si rezultat i sistemimit të mobilitetit në zone ne lidhje me lëvizjen e makinave, bicikletave dhe lëvizjen kembesoreve mendohet te jete jo vetem nje pike referimi (landmark) por një hapësire clodhëse, atraktive dhe funksionale me pershkueshmeri te mire në zonë. Projekti propozon koncept te pershkueshmerise. Kembesoret e pershkojne mikrohapeiren pa shqetesuar pushuesit por ne kete rast kjo hapserire si per kembesoret edhe per bicikletat evidentohet me nje instalacion te vecante qe kryen tre funksione ate te hijezimit, te ndricimit naten dhe ndjesior duke krijuar efekte nderkohe qe kalohet poshte instalacionit. Njeri krah i kyqezimit rruga "Mine Peza" eshte me nje sens levizje , nga qendra ne brendesi te zones. Ndaj edhe insalacioni merr nje rendesi te veçante dhe menyra e pozicionimi te tij jo vetem ka te bej me zonimin me te mire funksional por edhe me gjetjen e kendit me te mire te shikimit. Ne pjesen me te larget te sheshit nga godina kryesore kemi siperfaqe te plote gjelberimi. Prane kesaj siperfaqe kemi hapesiren e pasazhit ku eshte sistemuar edhe stacioni i bicikletave.

E vecanta e ketij sheshi eshte jo vetem ne mbulesen me siperfaqe reflektuese qe krijon nje "landmark" te ri ne qytet por edhe ne ndriçimin urban, ne elementet ules urban apo te shtrimit. Ne kete rast eshte perdorur pllake guri me siperfaqe katrore 50x50 dhe me trashesi 4cm. I pare nga lart kjo mikrohapësire ka nje unifikim te mire te shtrimit me kompozimin modular te stolave kubik te cilet se bashku formojen stola perimetral ne hapesirat e gjelberta. Edhe ne kete rast kompozimi i stolave eshte bere qe te ofroj pozicione te ndyhme ndejtje, prane dhe large godines kryesore.

Kompozimi i druveve eshte bere i tille qe te ndjeki linjen e levizjes se kembesoreve dhe te krijoj hijezim te pjesshem te hapesirave te çlodhjes pasi nje pjese e tyre gjate oreve te dites hijezohen nga godina apo nga instalacioni perpara tyre. Ne figuren 1 kemi planin e propozuar. Ne figuren 2 kemi planin e ndriçimit. Ne kete rast eshte menduar ndriçim pikesor ne kuoten e shtrimit te hapesires urbane duke u intesifikuar me shume ne formen e nje gridi nen instalacioni e propozuar.

Ndriçimi do te intensifikohet me shume nga siperfaqet reflektuese te strehes metalike i detajuar si ne fig 3. Menyra e shtrimit eshte detajuar ne fig 4. Ne kete rast pasi eshte pastruar toka natyrore nga mbeturinat qe ja ulin cilesin e perberjes se dheut, bejme mbushjen e pare me shtrese zhavori i cili eshte nje shperndares i mire i ngarkesave. Shtresa e zhavorit eshte 20 cm. Mbi te hidhet nje shtrese niveluese betoni me trashesi 20 cm. Mbi beton shtrohen pllakat e gurit me llaç çimento. Lidhja e shtrimit me trotuarin ekzistues behet nepermjet nje bordure betoni me permasa 10x25cm . Ne fig 5 paraqitet kondicionet e mbjelljes se pemeve.




Fig. 1




Fig. 2




Fig. 3




Fig. 4



Fig.7



Fig. 8

02 Objekti : Ndertimi i Mikrohapësirave Publike : Sheshi i Mimosave

Mikrohapësira urbane "Sheshi i mimosave" ndodhet shumë pranë qendrës së Tiranës afërsisht 400 m larg sheshit "Skenderbej" dhe përshkohet nga dy rrugë që kryqëzohen : "Kont Urani" dhe "Mihal Duri". Rruga "Kont Urani" është aksi kryesor lidhës midis Rr së Durrësit dhe Rr se Kavajës.

Përdorimi:

Hapësira e re mendohet të jetë jo vetëm një pikë referimi (landmark) por edhe një hapësirë me funksione publike si: pushimi/ pritje alternative për kalimtarët, parkim bicikletash që presin në hapësira urbane, me ndricim dhe sistemim të gjelberimit.

Projekti i mikrohapësirës urbane "Sheshi i Mimosave" propozon një risistemim të akseve të lëvizjes së makinave, biçikletave dhe lëvizjes së këmbësorëve. Rrugët do të vijojnë në formë unazore anash hapësirës së krijuar. Pjesa tjetër është një hapësirë e gjelber e kompozuar sipas një gridi të caktuar, një hapësirë shpërndarë nën kurorën e pemëve të mimosave, por që funksionon edhe si landmark për këtë zonë urbane.

Qëllimi:

Projekti i mikrohapësirës në fjalë ka si qëllim kryesor krijimin e hapësirës publike dhe rikonceptimin e asaj ekzistuese pavarësisht shkallës së vogël. Dizajni i "Kafe Flores" ka forca të theksosive të krijuara, të krijojnë apo forcojnë identitetin e këtyre poleve, të shërbejnë si rekreacion për jetën e përditshme dhe të jenë një atraksion për Tiranën turistike.

Elementët bazë:

1. Përcaktimi i qartë i mobilitetit, i lëvizjes së automjeteve dhe biçikletave .
2. Gjelbërimi i kompozuar në formën e një gridi i cili nuk pengon akseset vizuale të rrugëve me pemë mimoza.
3. Shtrimi me pllakë guri me permasa 5x5x5 cm
4. Stola me veshje si në figurën 4. Uljet e njerezve në hapësirat urbane bëhet me stol të shoqëruar me pemë dhe me materiale të ndryshme.
5. Hijezimi i hapësirave të hapura kryhet nëpërmjet pemëve.
6. Ndricimi urban
7. Zonimi dhe funksionet e shërbimit:

Përshkrimi i projektit:

Risistemimi i akseve qarkulluese të zonës bën të mundur qarkullimin në një sens dhe unazor të makinave. Rrugët e propozuara nuk kryqëzohen por vijojnë si formë unazore anash hapësirës së krijuar. Skema dhe sensi i ri i lëvizjes së makinave siguron mobilitet më të mirë të gjithë zonës dhe ul fluksin e makinave në zonë . Trupi i ri i rrugës është me një korsi kalimi për makinat, një korsi kalimi për bicikletat dhe siguron hapësirë të mjaftueshme për trotuarët ku fluksi i njerezve nuk shqetëson hapësirën çlodhëse si në fig 3.

Pema propozohet si element kryesor kompozicional dhe identifikues i sheshit. Kompozimi i grupeve të drurëve sipas një "gridi" (rrjeti) të caktuar krijon harmoninë, rregull dhe estetikë si në fig 3. Kompozimi parametrik i elementeve urban është si kërkesë për unifikim kompozicional dhe në vend të njëjti. Mobiliteti urban bëhet në baze të funksionit, bindjes

ndaj “gridit” kompozicional dhe estetikes, i orientuar drejt elementeve fin dhe të rehatshem duke siguruar harmonizimin e tyre te paraqitura ne fig 4. Materialet e stolave jane beton me pjese druri te lyer me llak rezistent ndaj ujit. Stolat do te jene ne total 5 cope. Ne fig.5 jane paraqitur karakteristikat e gjelberimit. Ne figuren 6 dhe 7 eshte i dukshem harmonizimi i materialit te shtrimit me mobilimin e sheshit. Materiali i shtrimit eshte zgjedhur me gure te vegjel me permasa 5x5. Pasi eshte bere sistemimi i tokes natyrore dhe vendosja e shtresave te zhavorit dhe te stabilizantit per te nivelur siperfaqen perkatesisht me lartesi 20 cm dhe 12 cm, hidhet nje shtrese tjetere niveluesi, rere me lartesi 6cm. Mbi shtresen e reres vendosen guret e larte 5 cm.




Figure 9




Figure 10




Figure 11




Figure 12




Figure 13



Figure 14



Figure 15

03 Objekti : Ndertimi i Mikrohapesirave Publike : Sheshi i Medresese

Mikrohapesira që propozohet për rehabilitim, me një sipërfaqe 477 m², ndodhet përpara godinës së Medresesë, e cila është në pronësi të Komunitetit Mysliman. Sheshi "Medreseja" kufizohet në Jug-Lindje me rrugën e "Dibrës" dhe në Perëndim me rrugën "5 Maji".

Përdorimi:

Sheshi i Medresesë aktualisht është një shëmbull tipik i mbipërdorimit të asfaltit dhe nuk rregullon aspak lëvizjen e makinave, këmbësorëve dhe biçikletave.

Kjo bën që si kryqëzim të funksionojë keq duke pasur probleme me sigurinë rrugore dhe jo vetëm.

Rikonceptimi ka të bëjë me përcaktimin e qartë të mobilitetit sa për sa i përket automjeteve, ashtu edhe të këmbësorëve dhe biçikletave.

Godina kryesore e mikrohapesirës në studim është monument i trashëgimisë kulturore. U hap për herë të parë në vitin 1924 si një institucion mesimor, fetar, kombëtar që përfshinte tre kategori: fillore, lice dhe universitet.

Duke arritur qartësinë e mobilitetit hapësira që ngelet përveçse shërben si një pasazh kalimi ajo kthehet në identitetin e zonës duke krijuar një zonë urbane që ofron vende për tu ulur, gjelbërim si dhe një vend tërheqës me një patern të veçantë në formë trekëndëshi.

Trekëndëshi gjendet në shkrimin e sheshit por edhe interpretohet në gjelbërim apo në format komplekse të stolave.

Elementët bazë:

1. Përcaktimi i qartë i mobilitetit, i lëvizjes së automjeteve dhe biçikletave
2. Hapësira e pasazhit, lëvizja e këmbësorëve
3. Hapësira e bustit dhe hapësira e çezmës
4. Patern-i në formë trekëndëshi që e kthen hapësirën në një atraksion urban
5. Gjelbërimi
6. Vende për tu ulur

Pershkrimi i projektit:

Dizajni urban i mikrohapesirës urbane kërkon realizimin e një programi të caktuar. Distanca midis bustit dhe objektit të marre në studim kërkon të marrë një përdorim që të jetë në shërbim të çlodhjes, si dhe pritjes dhe të zbusi në njëfarë mënyre trafikun e kësaj njeje shume të rëndësishme të shkarkimit të unazës me qytetin. Sipërfaqja që fitohet, konkretisht nga situata topografike, distancat e rrugës, të godinës, të banesave dhe të gjithë siluetit të ndertimeve që e rrethojnë këto pjesë, është në total 477 m². Edhe pse e vogël mikrohapesira "Medreseja" ka për qëllim zonimin dhe realizimin e disa funksioneve si: sistemimi i pjesës së bustit, orientimi i lëvizjes së këmbësorëve dhe biçikletave, qarkullimi i disiplinuar i makinave, hapësira me gjelbërim, vende për tu çlodhur për tu takuar etj. Ky projekt, këto zonime funksionale, i diferencon, por edhe i trajton si një të tjerë, sepse përdor një "pllake" apo "Pixel" trekëndor i të njëjtit material, në të njëjten mënyrë shtrimi, në një renditje që bën dallim, duke përdorur njollën, në konfiguracion dhe madhësi të pllakave. Është menduar që pjesë e ndërtimit të marrë një peshe, e cila krijohet nga përdorimi i pemeve. Pemet janë zgjedhur, gjethore, gjethërenese, dhe aromatizuese si në fig 5, ku paraqitet detaji i pemes së blirit. Ky kompozim drurësh i jep dimensione të ndryshme kësaj zone çlodhjeje duke si në dimer /vjeshtë dhe krejt ndryshe në pranverë/verë. Është për tu vlerësuar fakti që lëvizja e këmbësorëve për të kaluar nga unaza në drejtim të qytetit nuk shqetëson qëndrimin e pushuesve. Respekton interesin e tyre në vazhdim të lëvizjes pa

penguar funksionin e sheshit. Ka nje komunikim komod te levizjes se qytetareve ne trotuaret ekzistues te rrugeve qe vijne nga zona periferike per tu futur ne brendesi te qytetit. Qendra e mikrohapesires lihet e lire nga fluksi i levizjes se njerezve si ne fig 1.

Ne fig 3 eshte evidentuar distancat e stolave me godine kryesore te sheshit. Stolat mbeshteten plotesisht ne konfiguracionin e trekendeshit.




Fig. 1




Fig. 4 Logjika egjelberimit tenton te krijoj efektin e rritmit ne dizajnin urban




Fig. 5




Fig. 6




Fig. 7



Fig. 8

HAPESIRA PUBLIKE KASHARI SQUARE_PROJEKTI

PLANIMETRI GJELBERIMI



Mikrohapësirat Urbane | 101

Fig. 4




Fig. 7




Fig. 8




Fig. 9



Fig. 9



Mikrohapësirat Urbane | 117

Fig. 10

06 Objekti : Ndertimi i Mikrohapësirave Publike : Sheshi i Selites

Hapësira që propozohet për rikualifikim ndodhet pranë Blv.Bajram Curri dhe kufizohet me Rr. Irfan Tomini ,pranë gjimnazit “Besnik Sykja”.

Përdorimi:

Hapësira ekzistuese aktualisht përdoret si vend parkimi makinash. Terreni nuk ka disnivele të theksuar. Gjendja ekzistuese paraqet një imazh të degraduar të zonës dhe mundësi aksesit të limituar. Blloku i banimit në të cilin ndodhet mikrohapësira e propozuar është ndërtuar gjatë viteve 1950 me lartësi 5kate ndërtim.Hapësira e cila mendohet të rikualifikohet në shesh rekreativ nuk ka pasur një funksion të caktuar.Aktualisht ajo është një hapësirë pa një tipologji të caktuar.

Hapësira e propozuar për rehabilitimin e hapësirës urbane pranë Blv.Bajram Curri dhe rruges”Irfan Tomini” do të përdoret si lulishte / hapësire shplohëse, shesh rekreativ për banorët e bllokut të banimit.Në qendër të këtij sheshi rekreativ do të pozicionohet një shkallare me kubikë me disnivele,e cila krijon një mini amfiteatër me stolat perimetrale të sheshit.Trajtimi i sheshit është menduar të përshtatet të gjitha grupmoshave. Qëllimi i ndërtimit të sheshit rekreativ pranë Blv.Bajram Curri dhe rrugës”Irfan Tomini” është sistemimi e përmirësimi i imazhit të zonës, i funksionalitetit dhe krijimi i nje hapësire të përshtatshme nga të gjitha grupmoshat.


Elementët bazë:

1. Gjelbërimi
2. Patern me forma gjeometrike me tre ngjyra e cila e kthen hapësirën në një atraksion urban
3. Kënd pushimi
4. Amfiteatër/shkallare
5. Parkim


Pershkrimi i projektit:

Hapësira publike ndërmjet Blv.Bajram Curri dhe Rr. "Irfan Tomini" pranë karakterizohet nga një terren relativisht të drejtë dhe ka një sipërfaqe prej 845m². Sheshi përbëhet nga dy zona, zonën e parë ze një sipërfaqe prej 490m² e cila ndodhet përgjatë Blv.Bajram Curri dhe kemi menduar ta trajtojmë si hapësirë clodhëse/rekreative ndërsa zonën e dytë me sipërfaqe 355m² e trajtojmë si parkim. Në shtrimin e sheshit është përdorur formë gjeometrike këndrejtë duke i evidentuar me përdorimin e tre ngjyrave. Kemi menduar të ruajmë nivelin e drejtë duke pozicionuar në qendër një strukturë me tre ngjyra të formuar me kube(40x40) të ndara me fugë dhe me disnivele të ndryshme, në të cilën krijomë një mini amfiteatër. Ky është elementi përbërës i karakterit të kontekstit ku mendohet të implementohet rehabilitimi i hapësirës publike. Për të forcuar këtë element kontekstual mendohet ta trajtojmë duke përdorur të treja ngjyrat e shtrimit dhe duke vendosur një pemë në qendrën e tij. Në perimetër të sheshit është menduar të kemi hapësira të gjelbërta me pemë dhe barishte të egrra (Stipa) dhe me stola e cila do të shërbejë për të rritur nivelin e privatësisë në rrugicën që ndan sheshin dhe shkallaren me hapësirën e gjelbërt dhe ku janë vendosur stola. Pjesa jug-lindore e quajtur ndryshe zona 2 është menduar të përdoret për parkim, i cili do të jetë i shtruar me pllaka betoni me gjelberim në mes.


Shtrimi do të realizohet me beton agregat të sprucuar me tre nuanca ngjyrash, hapësirat e gjelbëruara dhe shkallarja do të kenë ndricim urban dhe kosha.



Trajtimi i zonës së sheshit rekreativ



Tajtimi i zonës së parkimit



Pamje 3 dimensionale

4. Zona per uleje dhe shplodhje

Pershkrimi i projektit:

Parku urban "Çajupi" eshte prone publike me siperfaqe 3100 m² ka te gjitha potencialet per te qene nje zone atraktive per te gjitha grupmoshatne. Ne project eshte trajtuar si nje park urban me dy sheshe te vogla ne te , Sheshin Çajupi dhe sheshin e Lojrave te tavolines. Te dy sheshet krijohen pole te tipologjive te ndryshme . Sheshi "Çajupi" eshte sheshi qendror i parkut. Eshte nje pike takimi dhe grumbullimi dhe nyje lidhese per pika te rendesishme ne shesh : si stacioni i autobuzit , ura kembesore mbi Lane dhe sherbimet qe gjenden ne park. Sheshi i Lojerave te tavolines, eshte krijuar si nje intalacion e landmark qe merr inspirimin nga vet funksionaliteti i kesaj zone, ku zhvillohen nga vete komuniteti lojrat e tavlones. Instalacioni mbulese krijon hije dhe hapësira te palevizshme uljeje. Mund te funksionojne edhe per funksione te tjera.

Ky "path" kryesor sherben si baza kompozicionale e te gjitha elementeve urban. Sipas projektit, kembesoret mund te kene edhe distance me te shkurtra ne pika te ndryshme te hapësires urbane. Te gjitha kryqezimet jane pika shume te mira aksesit ndaj edhe keto itinerare kalimi zgjerohen ne kryqezime ne formen e hinkave per te ftuar sa me shume kalimtare te rastit. Ne figuren 3 paraqitet koncepti I mbajtjes se dy linjave te pastra te kalimit dhe evidentimi I dy poleve kryesore me forma te regullta gjeometrike. Sheshi ka konfiguracion drejtkendeshi ndersa hapësira e lojes eshte ne konfiguracion rrethi. Ky evidentim me figura te regullta gjeometrike vjen si rezultat I bindjes kompozicionale ndaj elementeve kryesore urbane me te njejtin konfiguracion : si shkallet perreth Bustit , fig 5 dhe instalacionit ne fig 7. Hijezimi I hapësires se lojes krijon me shume komoditet per perdoruesit.

Ne zonat e gjelberuara ku shfrytezohen pemet ekzistuese shume vjecare si dhe vendosen te rejat eshte menduar te behet nje gritje e terrenit ne nje shkalle te vogel gati te pandjeshme. Ngritja e terrenit ne formen e unazave perqark seciles peme jo vetem qe e mbron mjedisin e gjelbert nen kuroren e tyre por sherben edhe per ulje. I jep mundesi pushuesit per te improvizuar menyra te ndryshme pushimi .Ne fig.2 paraqitet ne plan gjurma e terrenit te ngritur aq sa per te qendruar ne pozicion ulur mbi te. Gjithashtu ndritja e terrenit ne peme eshte paraqitur edhe ne pamjen, fig 11. Tek zona e trotuareve dhe tek hapësira e sheshit perpara busit eshte menduar qe shtrimi te behet me pllaka betoni me permasa 40x40x6 cm. Shtrimi i tyre behet mbi shtresen ekzistuese te trotuarit. Mbi shtresen ekzistuese shtrohet rere me trashesi 6cm dhe mbi to shtrohen pllakat e betonit. Si ne fig 9 dhe fig 10. Itineraret e reja te kalimit dhe siperfaqja rrethore e zones per lojra tavoline , shtrohet me beton te sprucuar.




Fig. 16




Fig. 17





Fig.18

Diagrama shpjeguese



- 1 Sheshi Cajupi dhe sheshi i Lojërave, dy polet kryesore te parkut urban
- 2 Itinerari kryesor dhe dytesor, si akses i domosdoshem per penetrueshmerine dhe pershtkrueshmerine e parkut. Zona e Sherbimeve
- 3 Zonat e gjelberuara ku shfrytëzohen pemet ekzistuese shume vjecare si dhe te reja. Zonat per ulje dhe shplodhje

Diagrame e konceptit




Fig. 19




Fig. 20

Vizualizim



Fig. 21

Vizualizim





Fig. 22




Fig.23




Fig. 24




Fig. 25



Fig. 26




Fig. 27

05 Objekti : Ndertimi i Mikrohapesirave Publike : Sheshi i Kasharit

Mikrohapesira e marrë në studim kufizohet nga rruga "Teodor Keko" ne Lindje, nga rruga "Henrik Lacaj" në Jug dhe nga rruga "Mikel Maruli" ne Veri – Perëndim.

Përdorimi:

Kashari sot eshte nje nga zonat me te populluara te Tiranës, por qe i mungon hapësira

publike dhe identiteti. I referuar gjithmone si zona Astir, tregon mungesen e nje indetiteti te forte qe te sherbeje si pike grumbullimi, shplodhjeje, pike takimi etj. "Kashari Square" eshte menduar ne nje nga hyrjet per ne brendesi te zones, eshte i dukshem e me vizibilitet te larte.

"Kashari Square" eshte dizenuar per nje perjetim intensive te hapesires publike. Rreth sheshit ka shume biznese restorative por mungon hapesira publike e lire per te krijuar te nje vendi te rregullt , te paster me elemente te vecanta, qe krijojne nje mjedis terheqes per njerzit. Mikrohapesira e re sherben si pike grumbullimi, shplodhjeje, pike takimi etj. Ne pjesen jugore te sheshit eshte propozuar nje stacion autobuzi. Sheshi lidh mjaft mire stacionin e autobuzit, me levizjen kembesore me hapesiren shplodhese dhe kalimet e ngushta qe te shperndajne ne sherbimet qe ngjenden prane kesaj "minilulishte".

Dizajni I "Kashari Square"ka si qellim kryesor krijimin e nje sheshi indetifikues dhe perfaqesues per nje lagje te Tiranës si Kashari, nje hapesire funksionale qe permireson fluksin e levizjes se kembesoreve duke i dhene perparesi dimensionit njerezor. Projekti modifikon menyren e referimit ne zone.

Elementët bazë:

1. Kodra natyrale me dhe edhe bar
2. Stacioni i autobuzit , fig 1 dhe stacioni i biçikletave, fig.4
3. Risistmimi i levizjes se kembesoreve ne zone duke krijuar kalime te ngushta pa shqetesuar zonen e çlodhjes, fig.3
4. Stola rrethor si ne fig 4 dhe 5.Uljet e njerezve ne qender te kesaj hapesire behet me stola te shoqeruar me peme dhe me materiale te ndryshme
5. Këndet e pushimit te treguar perkatesisht me numra: 1,2,3 si shkalle betoni te paraqitur ne fig. 6
6. Hijezimi kryet nepermjet pemeve te cialat jane gjethore dhe halore, perkatesisht portokaj te eger dhe pisha romake

Pershkrimi i projektit:

Hapesira publike "Kashari Square" me siperfaqe 1020 m2 eshte dizenuar si nje shesh me konfiguracion te rregullt gjeometrik, i pozicionuar ne zemer te nje mikrohapesire te gjelbert me peme perhere te gjelberta dhe me nje tapet bari te larte ne formen e stipave.

Karakteristike e ketij sheshi, i rrethuar nga siperfaqja e gjelber, eshte ngritja e terrenit ne nje nivel qe te krijojne intimitetin e duhur dhe mbrojtjen nga makinat dhe zhurmat. Ne brendesi te dunave te dheut jane pozicionuar kendet e qendrimin ne formen e shkalleve qe i binden morfologjise se terrenit. Ne fig. 7 paraqitet detaji i shkalleve dhe gjeometria e tyre ne forme L. Kodrat natyrale kane lartesi te ndryshme qe variojne nga 90 cm lartesi , 120 cm dhe me e larta 180 cm. Dunat me te larta pozicionohen ne krahun e unazes ku ndotja qe sjell fluksi I makinave eshte me e larte. Ne fig. 4 paraqitet ne menyre te dedajuar sistemimi i hapesires se gjelbert ne kuota çdo 20 cm. Hedhja e dheut behet ne shtresa nga 20 cm, lagen me uje dhe ngjeshet me tokmak. Keshtu veprohet per cdo shtrese me trashesi deri ne 20 cm deri ne shkallen e fundit. Ne fig. 4 jane paraqitur dimensionet e hapesirave te dunave, sa siperfaqe zejne ne rapor me hapesiren e shtruar. Shtimi eshte menduar me pllaka betonit me permasa 60x60x6 cm. Detaji i shtrimit eshte paraqitur ne fig 8. Ndricimi urban eshte nje elementet tjeter i rendesishem i sheshit. Ndricuesat jane propozuar ne koten e shtrimit per te ndricuar kurorat e pemeve, fig 9.



Fig. 28

Microspatial Urban | 115



Vizualizim




Fig. 29



HAPËSIRA PUBLIKE KASHARI SQUARE_PROJEKTI




Fig. 30